

BEDRI DEDJA

**RRETH AKSELERIMIT PSIKIK DHE NDIKIMIT TË TIJ
NË MËSIMIN E GJUHËS LETRARE**

Problemi i akselerimit aktualisht ka gozhduar vëmendjen e një tok shkencash. Ne mendojmë se, në veçanti, psikologjia fëmimore (infantile), ndodhet në një krizë, e cila përfaqëson vigjiljen e zbulimeve me vlerë të pallogaritshme për zhvillimin shoqëror. Sot më shumë se kurrë janë me kuptim të madh fjalët e Ajnshtajnit, sipas kujtimeve të Piazhës «*Sa e vështirë që është psikologjia në krahasim me fizikën*». Kjo e bën gati si proverbë thënjen e urtë se njohja e ndërtimit të atomit është lojë fëmijësh në krahasim me njohjen (shkencore) e lojës së fëmijëve.

A duhet rishikuar në themel, në këtë prizëm, edhe didaktika e gjuhës, në veçanti, dhe *edukimi* apo *edukata gjuhësore* në përgjithësi (pavarësisht se termi i fundit nuk është i afirmuar)?

Mendojmë se përvetësimi i rregullave të drejtshkrimit dhe mësimi i gjuhës letrare në të ardhmen do të varen, në radhë të parë, nga *edukata gjuhësore në moshat e vogla të fëmijëve*. Kur e shtrojmë këtë problem kemi parasysh dallimin, që bëjnë psikologët midis *gjuhës letrare*, si mjet objektiv material komunikimi dhe *të folurit letrar*, si proces komunikimi, si aftësi psikologjike, individuale dhe subjektive. Ura që i lidh ngushtë këto dy fenomene përfaqëson një aspekt themelor të shkencave pedagogjike e psikologjike. Qëllimi ynë përfundimtar është në këtë mes se si këtë gjuhë letrare objektive me gjithë rregullat e drejtshkrimit, ta kthejmë në një aftësi të çdo individi.

Ja, sepse duke e shtruar këtë problem, del e domosdoshme lidhja me akselerimin psikik dhe me ndikimin e këtij në perspektivën e mësimi të gjuhës letrare. Dhe këtu nuk kemi parasysh atë moshë të fëmijëve, që lidhet me institucionet arësimore, ku gjuha mësohet me program mësimor shtetëror. Ne na shqetëson më shumë ajo moshë, dhe ato institucione, ku mësimi dhe edukata gjuhësore nuk bëhen me një program të tillë rigoroz, ose bëhen fare pa program, por që kanë rëndësi ndoshta vendimtare për këtë proces.

Për këto arsye, besojmë, se për mësimin e gjuhës letrare *duhet shtruar një mënyrë konceptimi* e ndryshme nga mënyra tradicionale. Ky konceptim mbështetet në disa teza teorike të shtruar nga shkenca e sotme, në vëzhgime shumëvjeçare, në prova të thjeshta me karakter psikologjik si dhe në kundërvënie, si rrjedhim i disa parimeve të didaktikës së gjuhës.

Së pari, mendojmë, se përpjekjet e institucioneve tona arësimore-

edukative si dhe të gjithë shoqërisë sonë për mësimin e gjuhës letrare nuk mund të kurorëzohen me sukses të plotë, pa marrë në konsideratë, pa u përpjekur për t'i përvetësuar dhe gradualisht për t'i zbatuar *teoritë moderne mbi akselerimin psikik*. Dhe kjo duhet bërë pavarësisht nga karakteri i tyre kontradiktor si dhe përshtypja e menjëhershme, që lind mbi vështirësitë reale objektive të zbatimit të tyre, në krahasim me përvojën tradicionale që kemi për këto punë.

Në kohën tonë janë të njohura eksperimentet e guximshme për t'u mësuar shkrim e lexim fëmijëve normalë në moshën dy-tre-vjeçare. Në një farë mënyre janë goditur edhe konceptet e psikologjisë mbi mundësitë e fëmijëve, që lindin të shurdhër. Ka prova interesante, të cilat i kanë bërë këta fëmijë të aftë të përvetësojnë mirë gjuhën e folur me gojë e me shkrim në vitin e tretë dhe të katërt të jetës, në kohë kur nga përvoja e shkollave të posaçme dimë, që duke e filluar këtë punë në moshën shtatë vjeç dhe për dhjetë vjet me radhë, fëmijët e përvetësojnë dobët shqiptimin (gjuhën e folur).

Të gjithë këta shembuj e dhjetra të tjerë si këta, të cilët nuk i përmendim për kursim kohe, e kanë përmbysur pikëpamjen e vjetër mbi mundësitë (do të thoshnim fantastike për përfytyrimin tonë të sotëm) e moshës së fëminisë së hershme për zhvillim. Po të shprehemi në formë sintetike, sipas këtyre pikëpamjeve rezulton se «*gjer në tre vjeç njeriu përshkon gjysmën e distancës në zhvillimin e vet mendor*» (F. Gudinaf), se «*në lëmin e intelektit fëmija është i barabartë me ne, por atij i mungon vetëm përvoja*» (J. Korçak); «*fëmijët sot e ndjejnë më herët gatishmërinë dhe forcën e tyre të re drejt pjekurisë; në një kohë kur hynë më vonë në pjekurinë e vërtetë... dhe këtë dizarmoni e forcon pikërisht shkolla*» (T. Snjegirova). Ndërsa Vigotski nënvizon të ashtuquajturën periudhë sensitive, në bazë të të cilës të mësuarit jep më shumë frut, kur kryhet në periudhën e duhur.

Këtej buron teza me karakter transformues për teorinë e psikologjisë dhe të pedagogjisë, se të mësuarit duhet t'i paraprijë (ose së paku të ecë paralel) me zhvillimin e aftësive mendore dhe fizike të fëmijëve, pasi aftësitë, që nuk nxiten dhe nuk zhvillohen në kohën e duhur (besojmë se këtu shfaqet vlera e tezës së Vigotskit) në moshë të re, atëhere në një shkallë të konsiderueshme atrofizohen.

Së dyti psikologjia fëminore, me sa na duket ne, me të drejtë procesin e zhvillimit të të folurit tek fëmija e ndan në tri faza, të cilat janë: përvetësimi i fjalëve, si njësi të plota të të folurit, përvetësimi i ndërtimit gramatikor të gjuhës dhe mbi këtë bazë, pastaj, zhvillimi i të folurit të lidhur. Mendimi ynë është se në interpretimin e këtij periodizimi në psikologji dhe pedagogji duhet t'i ruhemi kuptimit mekanik. Të trija këto faza nuk janë procese të pavarura, që vinë varg njëra pas tjetrës dhe zëvendësojnë njëra-tjetrën. Përkundrazi, ato si të thuash, ecin në një farë mënyre si procese afërsisht paralele, të lidhur dhe të kushtëzuar nga njëri-tjetri. Po, megjithatë, *vendimtar për mësimin e gjuhës letrare që në moshat e njoma*, sipas mendimit tonë, është procesi i përvetësimit të fjalëve si njësi të plota të të folurit (kryesisht që nga fillimi i vitit të dytë të jetës së fëmijës). Por edhe kjo fazë nuk rrjedh spontanisht. Ajo varet tërësisht na duket ne nga të dëgjuarit e të folurit në mikroambientin familjar, nga cilë-

sia e të folurit të njerëzve, që komunikojnë me foshnjën në vitin e parë dhe të dytë të jetës, pra, nga faza e shqiptimit të tingujve e rrokjeve, të cilat janë parapregatitje për shqiptimin e fjalëve si njësi të plota.

Teza jonë pikërisht këtu gjen shprehje: ne e dallojmë fazën e përvetësimit të fjalëve si njësi të plota të të folurit, si më të rëndësishmen për edukatën gjuhësore të brezit të ri si dhe përvetësimin e gjuhës letrare. Dhe këtu na vjen në ndihmë si argument teoria e sotme e akselerimit psikik të moshave të vogla. *Ndërsa faktor pedagogjik për të arritur këto synime është drejtshqiptimi letrar i prindërve e, në mënyrë të veçantë, i nënës si dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes që komunikojnë me foshnjën, duke filluar nga java e tretë e jetës (që nga momenti kur organet e të dëgjuarit fillojnë të funksionojnë).*

Si një nga ilustrimet tona për këtë tezë, po sjellim shembullin e një vajze të vogël, sot me moshë tre vjeç e gjysmë (Entela N.), e cila përdor leksik gjirokastrit të përvetësuar në foshnjëri nga gjyshërit. Tani ajo jeton larg tyre, me prindërit, të cilët nuk e përdorin këtë leksik, megjithatë, Entela vazhdon të flasë: «dhize dritën» për «ndize», «prokë» për «pirun», «mbrostellë» për «përparëse», «niktike» për «këmishë nate», «cimbidhaq» për «mashë zjarri» ose «kapëse rrobash» etj.

Mbetet si një objekt interesant për t'u studjuar në mënyrë eksperimentale, se sa kohë dhe gjer në ç'moshë të fëmijës drejtshqiptimi letrar i prindërve dhe të afërmëve të tjerë të familjes vazhdon të luajë rol vendimtar për edukatën gjuhësore, gjer në tre, katër apo pesë vjeç? Nga vëzhgimet dhe provat tona, të cilat do t'i përmendim më poshtë, rezulton se në moshën shtatë vjeç e lart, shprehia e të folurit letrar me shkrim apo me gojë tek fëmija, merr trajta pak a shumë të plota. Kur e shprehim këtë mendim, nuk duam të mohojnë rolin që luajnë moshat e tjera në këtë proces, por ky nuk është objekt i studimit tonë.

Këtej del përfundimi se vëmendja e shkencave tona për edukatën duhet përqendruar me shumë seriozitet në statet e hershme të zhvillimit të fëmijës përgjithësisht, po edhe veçanërisht, pasi statet e hershme kanë rëndësi shumë të madhe për formimin e aftësisë së qëndrueshme të të folurit letrar (me gojë e me shkrim) në përputhje me kërkesat e shkencës sonë të sotme të gjuhësisë. Rëndësia e këtyre stadeve gjen shprehje, siç u tha, në pikëpamjen se mësimi i gjuhës letrare dhe në përgjithësi, edukata gjuhësore e brezit të ri përcaktohen nga drejtshqiptimi në të folur në komunikimin me fëmijën, pikërisht në fazën e fëminisë së hershme. Nga kjo më vonë do të përcaktohet shumë, në mënyrë të veçantë, kultura e të folurit me shkrim, që është detyrë e posaçme e shkollës e që ka vite pa u zgjidhur në një shkallë të kënaqshme, pavarësisht nga përsosja e vazhdueshme, që u është bërë programeve dhe teksteve të gjuhës shqipe, ose përsosja që mund t'u bëhet në të ardhmen.

* * *

Më poshtë dëshirojmë të shtrojmë disa argumenta, të cilat shërbejnë për ta mbështetur tezën si dhe përfundimin e mësipërm.

Një pikëmbështetje e parë në planin teorik është natyra e gjuhës sonë, e cila në formën e saj të shkruar ka gjetur një zgjidhje të mirë me alfabetin fonetik. Kjo pikëpamje përputhet plotësisht me zgjidhjet kryesore në «Rregullat e drejtshkrimit», të cilat mbështeten, në radhë të parë, në parimin fonetik, në shqiptimin më të përgjithshëm letrar që vihet në bazën e drejtshkrimit. Dhe dihet që këto mundësi sot nuk i kanë mjaft gjuhë të tjera.

Mësimi apo përvetësimi i gjuhës nga fëmija në moshë të njomë, i cili është ndër elementët më të parë të mëimit dhe të edukatës në përgjithësi, në këtë moshë, krahas krijimit të shprehive e zakoneve të thjeshta higjenike, fillon pikërisht nëpërmjet dëgjimit të shqiptimit në komunikimin me mikroambientin familjar. Pra, gjuha e folur, gjuha e shqiptuar nga të tjerët është elementi i parë i mëimit për foshnjën. Prandaj themi që, në rast se në stadet e hershme të fëmijës hidhen baza të shëndosha në përvetësimin e drejtshqiptimit, problemi i të folurit aktiv letrar (me gojë ose me shkrim), si aftësi psikologjike e fëmijës ndoshta hyn në rrugën e plotë dhe të sigurtë të zgjidhjes. E kundërta, në rast se në stadet e hershme të zhvillimit psikik të fëmijës, gjuha e folur, që përdoret me të vegjëlit është dialektale, apo nëndialektale etj., mësimi i gjuhës letrare dhe kultura gjuhësore e individit gjatë jetës, me gjithë punën e shkollës (po të mungojnë përpjekjet, do të thoshnim, titanike të individit), kalon nëpër shumë vështirësi, pengesa e peripeci, të cilat, ngandonjëherë, kur puna e shkollës është e dobët në lëndët e gjuhës dhe kur te individit mungojnë interesat gjuhësore, mund të bëhen edhe të pakapërcyeshme.

Këtë çështje ne jemi përpjekur ta vërtetojmë edhe praktikisht me të dhëna nga analiza e burimeve të literaturës shkencore, nga vëzhgimet shumëvjeçare dhe nga prova të thjeshta të bëra për këtë qëllim. Këto të dhëna nuk i kemi sistemuar dhe klasifikuar, po i shtrojmë, si të thuash, në tryezë, pasi të bëjnë të mendosh dhe të diskutosh.

Në morinë e materialeve të Kongresit XVII ndërkombëtar të psikologëve (në referimin e Midit, i cili flet për rolin vendimtar të moshës së vogël për zhvillim) gjejmë një shembull të vockël, mjaft interesant dhe me domethënje për qëllimin tonë, për rolin e moshës së njomë në përvetësimin e gjuhës: një fëmijë evropian, i cili jetoi gjer në moshën dy vjeç në Samoa, më vonë kur nisi të mësojë anglishten, vazhdonte të bënte gabime në të folur, që determinoheshin nga format gramatikore të gjuhës së Samoas, të përvetësuar në fëmësinë e hershme.

Vëzhgime të pedagogëve tanë («Mësuesi», 18.X.72) vënë në dukje se një pjesë e studentëve, që vinë në Universitet e kanë të vështirë t'i përvetësojnë disa nga rregullat e drejtshkrimit, sepse tek ata ndikojnë të folmet krahinore në të folurit me gojë (kuptohet edhe këtu të përvetësuar që në fëmësinë); tek këto ka një ndryshim midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar. Diktimet e bëra me nxënës për qëllime studimi («Mësuesi», 8.XI.72) tregojnë se gabimet e nxënësve janë

kryesisht të karakterit fonetik, të mospërputhjes së shqiptimit me grafinë etj., të cilat, për mendimin tonë, përsëri e kanë burimin te gjuha e dëgjuar që në fëmëni të hershme.

Nga ana jonë, nëpërmjet provës, janë krahasuar, nga njëra anë dy fëmijë (njëri 12 vjeç në kl. VI dhe tjetri 8 vjeç në kl. II) me fëmijë të klasave respektive të tri shkollave 8-vjeçare të kryeqytetit. Shkollat u zgjodhën sipas mikroambientit social, ku mbizotërojnë të folme krahinore, ose ku ka përzierje nga pikëpamja e profesionit si dhe e prejardhjes krahinore të prindërve. Dy fëmijët e parë janë rritur në një ambient familjar, ku me tendenciozitet dhe për qëllime studimi, kanë dëgjuar thuajse vetëm të folur letrar. Me këta dhe me klasat respektive, që u përmendën më lart, u zhvilluan dikttime me përmbajtje të njëjtë, me terma e fjalë të vështira të zgjedhura qëllimisht, në kl. VI me një sasi prej mbi 60 fjalësh dhe në kl. II prej rreth 15 fjalësh.

Rezultatet e korigjimeve treguan se dy fëmijët e parë nuk bënë asnjë gabim në tekstin e shkruar. Ndërsa 52 nxënësit e kl. II me ndikime të së folmes krahinore në mikroambientin social e familjar, bënë mesatarisht nga 4-5 gabime. 28 nxënësit e kl. II me mikroambient të përzier bënë mesatarisht 2-3 gabime. Pjesa dërmuese e gabimeve qenë ndikime të së folmes krahinore. Kurse 92 nxënësit e kl. VI bënë mesatarisht 7-8 gabime të së njëjtës natyrë. Përsa i përket kohës për të shkruajtur të njëjtin diktim, dy fëmijët e parë harxhuan, 7 vjeçari tre minuta e gjysmë, 12-vjeçari tetë minuta; klasat e dyta 15-20 minuta, kurse klasat e gjashta 30-35 minuta.

E gjithë kjo përkon me atë, që thonë gjuhëtarët tanë, se dialektet e të folmet e shqipes ndryshojnë sidomos nga fonetika. Kuptohet se pse ndikimet fonetike dialektale e krahinore bëhen pengesë serioze në sistemin tonë mësimor-edukativ për përvetësimin e gjuhës letrare dhe edukimin gjuhësor në përgjithësi.

E njëjta gjë duhet thënë, së fundi, vihet re edhe nga praktika e punës edukative në kopshtet parashkollore. Fëmijët vinë në kopshte, pohojnë edukatorët, me shumë të meta në shqiptim, në përvetësimin e fjalëve si njësi të plota, në përdorimin e trajtave gramatikore etj. Kjo gjendje paraqitet edhe më keq, kur fëmijët hyjnë në kopsht drejt-përsëdrejti në grupin e tretë, d.m.th. në moshën pesë ose gjashtë vjeç. Burimi i këtyre të metave janë përsëri, sipas mendimit të tyre, të folmet krahinore në familje, shqiptimi i shtrembër e përkëdhelës i prindërve, që imitojnë të folurit e fëmijëve «për lezet» në dy-tre vitet e para të jetës, si dhe përdorimi i së folmes krahinore nga vetë edukatorët. Në një grup të dytë (mosha 4, 5, 6 vjeç) të një kopshti të Lezhës, të studjuar për këtë qëllim, rreth 80% e fëmijëve paraqiteshin me të metat, që u përmendën më lart dhe vetëm 20% kishin të folur normal fëminor dhe pak a shumë afër të folurit letrar.

* * *

Këtej ne jemi përpjekur të nxjerrim edhe disa konkluzione në planin teorik dhe praktik.

Konkluzioni i parë ka të bëjë me idenë e lidhjes gjithnjë e më të ngushtë të mësimat të gjuhës letrare dhe të edukimit gjuhësor me

*fenomenin e akselerimit psikik, duke e spostuar vëmendjen drejt moshave sa më të vogla. Dhe bindjen për këtë çështje ne nuk e mbështesim vetëm në tezën e përgjithshme mbi mundësitë shumë të gjera për zhvillim të moshave të vogla. Ne kemi përshtypjen se ka një përshpejtim real (këto tri dekada të fundit) të të folurit shqip tek moshat e hershme të fëmijëve tanë. Ky akselerim i të folurit, gjen shprehje në një drejtshqiptim letrar, ngandonjëherë të çuditshëm në këto moshë. Nuk ka asnjë dyshim se këtu ka ndikuar zhvillimi i jetës sonë në të gjitha aspektet e veta, po sidomos zhvillimi kultural-arësimor. Treguesit e këtij akselerimi të të folurit janë, në radhë të parë, drejtshqiptimi dhe pasuria e hershme e fjalorit të fëmijëve në moshat e ulta. Nga vëzhgimet tona ne kemi parë raste, kur fëmijët në fund të vitit të parë të jetës kanë arritur të përdorin aktivisht 10-15 njësi leksikore, thuhetse të plotë; në dy vjeç të riprodhojnë përrallën e shkurtër me ndihmën e dialogut (E. P.); në dy vjeç e gjysmë të shqiptojë drejt dhe si njësi të plotë fjalën «ventilator» (E. N.), në dy vjeç e nëntë muaj (fëmijë i takuar rastësisht) të shqiptojë si të rriturit fjalët *liqeni artificial*; në çerdhen numër 5 të kryeqytetit kemi takuar një fëmijë në prak të tre vjetëve, që u bënte këto korigjime të drejta moshatarëve: «Jo, kali i Gëxhebeut, po i Skënderbeut... Jo ëli babi çëçëpi, po ërdhi babi në shtëpi... Jo rrofsh, moj mëma Pishpëri, po nëna Shqipëri!». Një fëmijë tetë vjeç, pasi kish marrë në dorë përmbledhjen për fëmijë të Kristoforidhit «*Kali, qeni, dhija dhe...*», të botuar disa vjet më parë, e la librin mënjanë, dhe me sinjeritet naiv fëmijor, tha: «Ohu, këta s'kanë ditur të flasin gjuhë letrare shqipe!...». Ne besojmë se po të ishte dëshmitar i këtij akselerimi të të folurit të fëmijëve tanë të mrekullueshëm sot, Kristoforidhi shumë i nderuar do t'i gëzohej dhe kurrë nuk do t'i zëmërohej kësaj kritike naive fëmimore.*

Konkluzioni i dytë lidhet me një problem mjaft të ndërlikuar social e kultural, me kulturën gjuhësore të familjes sonë në përgjithësi. Gjuha e familjes, veçanërisht, në dy-tre vitet e para të jetës së fëmijës, është një faktor vendimtar për edukatën gjuhësore të brezit të ri. Po të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm se ky është një proces i gjatë, që për të hyrë në rrugën e zgjidhjes së plotë do kohë. Po si problem, çështja e kulturës gjuhësore të prindërve dhe e rolit të saj në akselerimin e të folurit të fëmijëve, duhet njohur për ta stimuluar atë me të gjitha format e mënyrat, duke qenë të ndërgjegjshëm, se kjo kulturë varet nga faktorë subjektivë dhe objektivë. Por, në asnjë mënyrë kjo nuk duhet të na çojë në përfundimin që, në përgjithësi, akselerimin e të folurit letrar të fëmijëve ta shohim si një proces spontan. Mendimi është se, pavarësisht nga ritmet, që do të ketë ngritja e kulturës gjuhësore të prindërve në nivelin e gjuhës së sotme letrare, ne kemi mundësi që akselerimin e të folurit të fëmijëve ta drejtojmë si proces në mënyrë të vetëdijshme dhe të organizuar. Me këtë ide dhe lidhen dy konkluzionet tona të fundit.

Prandaj, si një rrugë, ne duhet të shtrojmë problemin shtetëror dhe shkencor të kulturës gjuhësore të edukatoreve të institucioneve parashkollore, kopshteve dhe çerdheve, pasi kjo do të ishte një forcë e madhe për të ekuilibruar ato boshllëqe, që vinë për mungesë të kul-

turës gjuhësore të prindërve. Po në fakt, sot për sot çerdhet ne i kemi pa programe shtetërore edukimi, siç i kanë kopshtet dhe këto probleme thuhet nuk njihen nga personeli i tyre. Në kopshte, pavarësisht nga programi, në përgjithësi punohet dobët për akselerimin e të folurit letrar të fëmijëve. Prandaj, si masa konkrete mund të përcaktohen dy: futja e programit shtetëror të edukimit në çerdhe dhe përgatitja e kualifikimi gjuhësor i gjithë edukatorëve të institucioneve parashkollore.

Si rrugë tjetër, mendojmë, duhet ndjekur eksperimentimi masiv për problemet e gjuhës letrare.

Si e kuptojmë këtë problem?

Ka zëra, të cilët, duke vërejtur dobësitë e mësimin të gjuhës në shkollat tona, priren për të propozuar që t'i shtojnë orët e kësaj lënde në shkollë dhe kthimin tek e kaluara për ta rifutur lëndën e gjuhës shqipe në shkollat e mesme. Kjo mund të jetë një rrugë. Por kjo nuk është tendencë, me sa duket, që u përgjigjet përfytyrimeve moderne shkencore. Prirja për mësimin e gjuhës shqipe nuk duhet të jetë më shumë për t'u ngjitur, se sa për të zbritur; jo nga shkolla 8-vjeçare në të mesmen, por nga 8-vjeçarja në kopësht dhe medoemos në çerdhe. Veçanërisht hallka e fundit është me rëndësi shumë të madhe.

Po ky proces i uljes, duhet të jemi realistë, është kontradiktor. Dhe kontradikta gjen shprehje, sipas përvojës së gjersotme, në hendekun midis mundësive të mëdha të moshave të vogla për përvetësim dhe mjeteve primitive të shkrimit, që ne përdorim në shkolla sot për sot. Se duhet të themi që mësimi i gjuhës letrare mund të krijojë shprehi të qëndrueshme, në rast se ecin paralel si gjuha e folur, ashtu edhe gjuha e shkruar (pra, shprehitë e shkrimit).

Përvoja e përfshirjes së fëmijëve 6-vjeçarë në masë në kl. I, tregon, siç pohojnë mjaft mësues, se përvetësimin e shkrimit me penë e bojë, këta nxënës fiziologjikisht e kanë të vështirë, për shkak të muskulaturës së gishtrinjëve. Ne mendojmë, se këtu ushtrojnë ndikimin e vet mjetet e sotme të shkrimit, të ushtruarit e pamjaftueshëm në vizatim në kopshte si dhe tradita e vjetër për kuptimin e aftësisë së shkrimit.

Në të ardhmen nuk ka dyshim që shkrimi i dorës do të vijë duke zënë gjithnjë më pak vend në jetën e njeriut me zhvillimin e mjeteve teknike të shkrimit. Prandaj, që tani, për t'iu përgjigjur akselerimit, si në të folur, ashtu edhe në lexim e në të shkruar në moshat e vogla, ne nuk duhet të presim forcimin e muskulaturës së gishtrinjëve. Duke prodhuar në sasira të mëdha gërma dhe rrokje lëvizore të shtypura në formate të përshtatshme për moshën (pak a shumë siç vepron me gërmat lëvizore të Abetares), shkrimi në këtë mënyrë mund të eksperimentohet në kopshte, duke zbritur nga gjashtë në pesë vjeç, në katër. Ne kemi tani shembuj të shumtë fëmijësh që fillojnë ta mësojnë abetaren në pesë vjeç. Këto eksperimente mund të fillohen me faza e në mënyrë të pjesshme në grupe kopshtesh. Eksperimentimi i një shkrimi të tillë do të ishte një mjet tjetër i organizuar dhe i drejtuar për t'ju përgjigjur disi mundësive për zhvillim të moshave të vogla, si dhe akselerimit të të folurit letrar shqip të fëmijëve tanë, të cilët tanimë janë fenomene reale dhe nuk mund të mbeten jashtë vëmendjes së shkencave tona pedagogjike dhe gjuhësore.

